

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Del nga burgu “numri 2” i Agimit të Artë Ilias Kasidhiaris, synon rikthimin në politikë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/15/del-sot-nga-burgu-numri-2-i-agimit-te-arte-ilias-kasidhiaris-synon-rikthimin-ne-politike/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 08:33:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	15 shtator 2026, 08:29:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 15 shtator 2026, 08:28:00 UTC → 15 shtator 2026, 08:30:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aeac1794bb0764ccb685cd24b8c21e36706a309c3f86f4c52b55d86207da5c53
TEKSTI	36bf7ac7b80487fd5d6961aa9f701e35713509d15f2cf46b860b851c86cc6bc7
PAMJA	34fbc04994cec72f17b579044e798593652f548f190954c390b8d234ff101d7b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e733d3ce5eef008e638539bb63e80369eb4a2aad4ae8bcad117adf3133a26f24
E MËPARSHMJA	5665bb92b22a380d452ad103ce08495bd046299e75f19399b09c9c9a64dc46c1
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e733d3ce5eef008e638539bb63e80369eb4a2aad4ae8bcad117adf3133a26f24>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

Del nga burgu “numri 2” i Agimit të Artë Ilias Kasidhiaris, synon rikthimin në politikë

15/09/2026 10:29



Ilias Kasidhiaris, një nga figurat më të fuqishme të Agimit të Artë dhe për vite me radhë i konsideruar si krahu i djathtë i liderit Nikos Michaloliakos, ka dalë sot nga burgu i Domokosit, pas përfundimit të dënimit të tij për drejtimin e një organizate kriminale.

Kasidhiaris ishte dënuar me 13 vjet burg, pasi Gjykata e Apelit në Athinë konfirmoi vendimin historik se Agimi i Artë funksiononte si “organizatë kriminale nën petkun e një partie politike”. Bashkë me të, për drejtimin e organizatës u dënuan edhe Nikos Michaloliakos, Giannis Lagos, Christos Pappas, Giorgos Germentis, Ilias Panagiotaras dhe Artemis Matthaiopoulos.

Kasidhiaris lirohet sot pasi, sipas avokates së tij, ka plotësuar të gjithë dënimin sipas mënyrës së llogaritjes së parashikuar nga kodi penitenciar. Rreth shtatë vjet janë vuajtur realisht, përfshirë paraburgimin, ndërsa rreth gjashtë vite të tjera janë llogaritur përmes ditëve të punës në burg, ku në raste të caktuara një ditë pune llogaritet si më shumë se një ditë dënimi.

Agimi i Artë hyri për herë të parë fuqishëm në parlamentin grek në vitin 2012, në kulmin e krizës ekonomike dhe politike. Në zgjedhjet e qershorit mori 6,92% të votave dhe 18 deputetë. Në vitin 2015 ruajtë pothuajse të njëjtën forcë, me rreth 7% dhe 18-19 deputetë, ndërsa në zgjedhjet e vitit 2019 ra nën pragun e kërkuar prej 3% dhe mbeti jashtë Parlamentit.

Hetimi penal kundër Agimit të Artë mori përmasa vendimtare pas vrasjes së muzikantit antifashist Pavlos Fyssas në shtator 2013 nga Giorgos Roupakias, anëtar i organizatës. Procesi gjyqësor zgjati për vite dhe në vitin 2020 gjykata shpalli fajtorë të gjithë 18 ish-deputetët e grupit parlamentar të Agimit të Artë: shtatë për drejtim të organizatës kriminale dhe 11 të tjerë për anëtarësim në të. Në shkallën e dytë, në mars 2026, u shpallën fajtorë të gjithë 42 të pandehurit që kishin vazhduar procesin e apelit.

Burgimi nuk e ndërpreu aktivitetin publik të Kasidhiaris. Nga qelia e tij në Domokos ai vazhdoi të komunikonte përmes rrjeteve sociale, videove dhe transmetimeve në internet dhe tentoi të mbante një parti politike.

Në zgjedhjet e vitit 2023 ai tentoi të marrë pjesë me partinë “Ellines” (Grekët), por Gjykata e Lartë bllokoi pjesëmarrjen, duke e konsideruar atë udhëheqës real të formacionit. Më pas ai mbështeti partinë “Spartiates”. Në qershor të vitit 2025, Gjykata e Posaçme Zgjedhore u hoqi mandatet tre deputetëve të kësaj partie, duke vlerësuar se elektorati ishte mashtruar dhe se drejtuesi i fshehtë dhe udhëzuesi real i partisë ishte Ilias Kasidhiaris.

Edhe nga burgu ai u zgjodh këshilltar bashkiak në Athinë në vitin 2023, ndërsa vazhdoi të mbante lidhje me mbështetësit e tij dhe të paralajmëronte rikthimin në skenën politike.

Kryesore



Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

11:06

Dosja “Revanshi”/ GJKKO shpall vendimin, 50 vite burg për Durim Bamin dhe gjashtë të pandehurit e tjerë

09:32

Cënuan perimetritin e sigurisë në shkolla gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë

10:39

Vuçiç zbulon datën e dorëheqjes, presidenti i Serbisë: Fushatën e vazhdoi si qytetar i thjeshtë

11:34

Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City

09:50

Më të lexuarat

Mbyllet gjyqi ndaj Thaçit në Hagë! Procesi për pengim të drejtësisë, mbrojtja kundërshtoi transkriptet e prokurorisë dhe kërkoi pafajësi

25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin “Atelier 4” dhe “Green Coast”

Mbretëria e Bashkuar po dridhet/ Skocia, Uellsit dhe Irlanda e Veriut kërkojnë referendum: E ardhmja jonë është në BE

Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

Tensionet zhvendosen në hapësirë, SHBA pranon se ka armë në orbitë: Rusia dhe Kina konsiderohen kërcënime kryesore

“China Zorrilla”, anija më e madhe elektrike në botë mbërrin në Uruguai, nis udhëtimet në tetor

“O kukull, projektligji për kinemanë do deformatë filmin duke futur video-lojëra”, Mevlan Shanaj përballet live në “Ftesë në 5” me drejtorin e QK, Jorgji: Po flitet keq për njerëz që punojnë

“FBI kishte mijëra përgjime për Al Caponen, por s’kishte prova”, Filip Çakuli: Veliajn e arrestuan nga thashethemet, e linçuan publikisht

Nga një ‘like’ në Instagram te propaganda

Çështja kryesore tashmë është fakti nëse ai mund të kandidojë sërish. Vetë Kasidhiaris ka deklaruar se del nga burgu me "të drejta të plota politike" dhe ka paralajmëruar konferencë shtypi për të prezantuar planet e tij të ardhshme. Avokatja e tij ka thënë se pjesëmarrja e tij në zgjedhjet e ardhshme është e sigurt.

Por ligjërisht çështja nuk është e mbyllur. Ligji i miratuar në vitin 2023 ndalon pjesëmarrjen në zgjedhje të formacioneve ku drejtuesi real është person i dënuar për drejtim ose pjesëmarrje në organizatë kriminale. Juristët nuk bien plotësisht dakord nëse ndalimi për Kasidhiaris përfundon me lirim nga burgu apo vazhdon për gjithë kohëzgjatjen formale të dënimit.

Në çdo rast, fjalën e fundit do ta kenë sërish gjyqtarët e seksionit politik të Gjykatës së Lartë, të cilët do të vendosin nëse ai mund të jetë kryetar partie, kandidat për deputet apo drejtues real i një formacioni tjetër. Dhe pikërisht këtu përqendrohet edhe debati që ka hapur shtypi grek. Gazeta "Efimerida ton Syntakton" shkruan se Kasidhiaris po përgatit prej muajsh kthimin e tij politik dhe se tashmë synon "normalizimin institucional" të pranisë së tij, këtë herë jo përmes brigadave të sulmit në rrugë, por kryesisht përmes rrjeteve sociale dhe ndikimit të një pjesë e elektoratit, veçanërisht tek të rinjtë.

Dalja e tij nga burgu, vetëm pak ditë përpara përvjetorit të vrasjes së Pavlos Fyssas, rikthen kështu në qendër të politikës greke një pyetje që dukej se ishte mbyllur me dënimin e Agimit të Artë: a mund të kthehet politikisht një nga drejtuesit e tij kryesorë pasi ka përfunduar dënimin penal?

Mos harrojmë edhe faktin që rikthimi i Kasidhiaris ndodh vetëm pak muaj para zgjedhjeve parlamentare, në një moment kur skena politike greke është më e fragmentuar se kurrë. Demokracia e Re mbetet forca e parë, por përballat me pakënaqësi të fortë, ndërsa në të djathtë të saj konkurrojnë disa formacione konservatore dhe të ekstremit të djathtë.

Në anën tjetër, partitë progresiste dhe të qendrës së majtë vazhdojnë të jenë të ndara dhe pa një alternativë të vetme të qartë qeverisëse, duke përjashtuar edhe çdo mundësi bashkëpunimi. Në këtë terren synon të rikthehet Kasidhiaris, duke u përpjekur të paraqitet jo më me simbolikën e hapur neonaziste të Agimit të Artë, por me një gjuhë "patriotike", antisistem dhe kundër elitave politike.

Pikërisht këtu lind edhe paralajmërimi që bëjnë disa media greke se "historia mund të përsëritet – si farsë ose si tragjedi". Edhe në vitin 2012, Agimi i Artë përfitoi nga zemërimi social, kriza ekonomike dhe mosbesimi ndaj partive tradicionale për të hyrë në parlament.

Sot Greqia nuk ndodhet në të njëjtën situatë. Por disa nga kushtet politike që ushqyen atëherë ekstremizmin, si pakënaqësia, shtrenjtësia e artikujve ushqimorë, karburanteve, qirave apo dhe skandalet politike çojnë në kërkimin e një vote ndëshkuese, janë përsëri të pranishme. Pyetja shtrohet nëse rikthimi i Kasidhiaris do të mbetet një episod politik periferik, apo nëse do të kthehet sërish në faktor që do të ndikojë ekuilibrat në të djathtë të skenës politike greke.

Top Channel

serbe, si u shemb skandali i 'kushteve të këqija' në Tiranë

Pikë referimi për shqiptarët në Itali/
Inaugurimi i Konsullatës së Nderit të
Shqipërisë, kryeministri Rama në Napoli për
ceremoninë

I Bota »



Bill Gates ngre alarmin për IA-në: Asnjë shtet nuk është gati për ndryshimet që inteligjenca artificiale do sjellë në botë

15/09 10:21




Alarm në ujërat ndërkombëtare, fregata ruse lëshon dy raketa drejt një helikopteri danez

15/09 10:17



Trump çmonton politikat e Biden për klimën: Më shumë qymyr dhe gaz natyror për prodhimin e energjisë elektrike

15/09 09:30



Kina shtrëngon rregullat e udhëtimit, qytetarët mund të ndalohen të largohen nga vendi

15/09 09:10

Pentagoni pranon mungesën e municioneve pas luftës me Iranin, shpenzimet arrijnë në 33.4 miliardë dollarë

15/09 08:40

Incident pranë territorit të NATO-s, avionët luftarakë rrëzojnë një dron mbi Lituanë

15/09 07:58

Na ndiqni:

Top Channel

@topchannelalbania

@tchbreakingnews

Top Channel

Video »



Top Channel/ "Frika nga AI, një mashtrim": Trump kundërshton rregullat mbrojtëse!



Top News – Kushtetuesja nuk bind Gjykatën e Lartë. Kolegji Ië në fuqi 'arrestin me burg' për Veliajn



Top Channel/ Ngërci politik në Kosovë, SHBA e pakënaqur: Po pengon axhendën e përbashkët!



Top Channel/ Debate te "Xhafaj", kryetari: Rastet të trajtohen, kam bërë 7 ankesa për zhurmën dhe...



Top News – Pak orë nga vendimi për Thaçin. Por transmetimi 'live' do të jetë 10 minuta me vonesë



Top Channel/ Vucic: Jap dorëheqjen në 27 shtator, fushatën e vazhdoj si qytetar i thjeshtë!

Lajme

- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

Bota

- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

Sport

- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

Pop News

- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

Programe

- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

Top Channel

- Rreth Top Channel
- Bileta
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.